

PJESA HYRËSE

1. Objekti, rëndësia dhe arsyeshmëria e trajtimit të ndërmjetësimit

Çështja e trajtuar në këtë temë në boshtin kryesor të saj përmban aplikimin e ndërmjetësimit si metodë alternative në procedurë penale. Punimi fokusohet në procedurën e ndërmjetësimit në fushën penale si metodë e avancuar e zgjidhjes së çështjeve penale kur rrezikshmëria e veprave penale që mund të referohen në ndërmjetësim është më e vogël dhe po ashtu edhe sanksioni penal i përcaktuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Ky punim kufizohet në kohë dhe në hapësirë, pranë institucioneve dhe atë duke u kufizuar vetëm në ndërmjetësimin penal në periudhë nga viti 2012 deri në vitin 2017 në referimin e rasteve në ndërmjetësim pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë. Tema nuk përfshin analizimin e ndërmjetësimit tradicional – kanunor (pleqnimit) ngase në procedurën e ndërmjetësimit, palët kanë “pronësi” mbi ndërmjetësimin dhe vendimet e marra nga ato dhe se mosmarrëveshjet zgjidhen vetëm me vendimin e palëve¹.

Ndërmjetësuesi është përgjegjës për procedurën e ndërmjetësimit dhe është përgjegjës për zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve të cilat përcaktohen në legjislacionin në fuqi, rregullat e gjykatës, kodin etik, marrëveshjet për ndërmjetësim dhe instrumentet tjera ligjore të cilat zbatohen në ndërmjetësim².

Si zgjidhje e përgjithshme e mosmarrëveshjeve e normuar në ligj, ndërmjetësimi fillimisht ka qenë i rregulluar me Ligjin për Procedurën Kontestimore (LPK) me nr. 4/77 i datës 14. 01. 1977, nenin 186, e më vonë edhe me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës të vitit 2003 (UNMIK/RREG/2003/25), ndërsa, në vitin 2008 ka hyrë në fuqi ligji për ndërmjetësim (i shfuqizuar³) i cili ka parashikuar ndërmjetësimin në fushën penale, civile, punës, administrative etj. Zbatimi i ligjit për ndërmjetësim është bërë i mundur pasi janë themeluar qendrat e para të ndërmjetësimit fillimisht në Gjilan, Pejë e pastaj edhe në qytetet tjera.

Tema ka rëndësi akademike dhe praktike meqë ndërmjetësimi në periudhën nga viti 2012 deri në vitin 2017 ndër të tjerash ka pasur efekt në zgjidhjen e mos marrëveshjeve, uljen e numrit të rasteve penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë, është vlerësuar si institut i suksesshëm edhe nga raportet ndërkombëtare siç është raporti i progresit të Bashkimit Evropian. Ndërmjetësimi nuk ka qenë dhe nuk është metode zëvendësuese të ndonjë procesi gjyqësor. Ndërmjetësimi nuk përbën zgjidhje të kontesteve në kërkesë për të ikur/shmangur nga mekanizmat gjyqësor.

Arsyeshmëria e temës mbështetet në faktin se instituti i ndërmjetësimit në fushën penale është trajtuar gjerësisht, mirëpo, si institut ka mungesë të trajtimit në kuptim më të ngushtë duke u kufizuar në periudhë dhe juridiksion territorial. Fillimisht përcaktimi i mirë i fushës së studimit në kuptimin kohor ka përcaktuar edhe kufizimin në literaturë ashtu edhe në

¹ Allan J Stitt, *Mediation: A Practical Guide*, 2004, fq.17.

² Nadja Alexander, *International Comparative Mediation: Legal Perspectives*, Wolters Kluwer, Law & Business, 2009, fq. 215.

³ Ndërmjetësimi si procedurë alternative e zgjidhjes së kontesteve edhe në çështje penale në Kosovë ishte i paraparë edhe me Ligjin nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim, miratuar me 18.09.2008.

gjenerimin e konkludimeve. Megjithatë, literatura e përdorur ndërkombëtare dhe vendore është përzgjedhur me kujdes. Mbledhja e të dhënave statistikore edhe në këtë fushë ka paraqitur sfidë të veçantë, kjo për faktin se institucionet e drejtësisë nuk kanë një sistem të integruar, dhe se shënimet janë mbajtur nga zyrtarët përgjegjës dhe se shënimet janë nxjerr pas krahasimit të disa burimeve. Për të realizuar me sukses objektivat në këtë studim jemi mbështetur në metodat e shënuara si më poshtë. Do të trajtohen disa aspekte të ndërmjetësimit penal në legjislacionin tonë material dhe procedural, mekanizmat i referimit dhe protokollit për referim të rasteve penale, do të analizohen disa sisteme të vendeve të BE-së, SHBA, akteve të Kombeve të Bashkuara dhe vendeve të rajonit tonë.

Për nga aspekti juridik dhe institucional, ndërmjetësimi njihet si institut juridik përmes të cilit mund të trajtohen një numër i veprave penale të përcaktuara në bazë të Kodit Penal si dhe në përputhje me parakushtet e vendosura nga Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Drejtësisë për të Mitur, si dhe në përputhje me Ligjin për Ndërmjetësim. Rasti mund të referohet në ndërmjetësim kur plotësohet parakushtet ligjore dhe vullneti i palëve në procedurë dhe kështu, palët zgjidhin mosmarrëveshjen përmes ndërmjetësuesit. Palët e përfshira në procedurë të ndërmjetësimit realizojnë kërkesat e tyre në procedurë më të shpejtë, kjo po ashtu zvogëlon numrin e lëndëve të pa zgjidhura të karakterit penal.

Për nga aspekti akademik, ky punim do të sjell një studim të mbështetur në literaturë, praktikë, intervistime, dhe statistika.

Për nga aspekti institucional, ky punim do të përmban vlerësim akademik të zhvillimit të ndërmjetësimit, ndryshimeve dhe zhvillimit ligjor përmes ligjit të përgjithshëm dhe bazik të ndërmjetësimit si dhe legjislacionit penal që i referohet ndërmjetësimit. Punimi nuk do të zgjerohet në ndërmjetësimin e kontesteve tregtare dhe civile ose administrative.

2. Metodologjia e punës

Për përgatitjen e këtij punimi janë përdorur metodat si në vijim:

Metoda historike, përmes kësaj metode do të paraqitet zhvillimi i ndërmjetësimit në fillet e tij të fushës penale, nga i cili edhe buron ndërmjetësimi institucional penal, meqenëse shteti ka konsideruar se ndërmjetësimi është i një rëndësie të veçantë, është rregulluar infrastruktura ligjore dhe ndërmjetësimi është inkorporuar në rendin juridik të Kosovës përmes një numri të ligjeve penale dhe jo vetëm.

Metoda juridike-dogmatike, përmes kësaj metode do të paraqitet nocioni, qëllimi, funksioni, parimet dhe karakteristikat e ndërmjetësimit në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, duke u kufizuar në legjislacionin e përgjithshëm dhe legjislacionin penal si dhe disa nga aktet nënligjore. Do të arrihet të analizohen dispozitat të cilat e rregullojnë fushën e ndërmjetësimit në Kosovë, rajon dhe në disa vende të BE-së.

Metoda statistikore, përmes kësaj metode do të paraqiten të dhënat e rasteve të referuara në procedurë të ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Prishtinë për periudhën 2012-2017 në Prishtinë për të cilat ka informacion të besueshëm dhe zyrtar. Këto të dhëna do të paraqiten edhe në formë tabelore dhe do të përmbajnë të dhënat përkatëse kur ato janë të qasshme.

Metoda e analizës, përmes kësaj metode do të analizohet aspekti ligjor mbi bazën e të cilit trajtohen rastet penale përmes procedurës së ndërmjetësimit e në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të bëhet analizë ligjore e ndërmjetësimit dhe procedurës së ndërmjetësimit sipas legjislacionit në fuqi, analizë e legjislacionit në vendet e rajonit, Bashkimit Evropian dhe standardeve të OKB-së.

Metoda e anketës dhe intervistës, përmes kësaj metode do të aplikohet intervista dhe anketa me akterët relevant të zbatimit të ndërmjetësimit, si: ndërmjetësuesit, ish anëtarët e Komisionit të Ndërmjetësimit, prokurorët, gjyqtarët, etj.

3. Struktura e punimit

Punimi me titull **“Ndërmjetësimi në procedurën penale me vështrim të vecantë në Gjykatën Themelore në Prishtinë në periudhën nga viti 2012 deri në vitin 2017”** ka katër kapituj:

Në **Kapitullin I “Vështrime të përgjithshme për ndërmjetësimin në procedurë penale”** do të trajtohen nocionet si Ndërmjetësimi, parimet dhe procedura, do të përfshihen edhe tezat se përse është e përshtatshme zgjidhja e mosmarrëveshjeve me anë të ndërmjetësimit në procedurë penale? Dallimi në mes të ndërmjetësimit dhe të drejtës restorative; cilat janë përfitimet nga ndërmjetësimi në fushën penale dhe a mund të shërbej ndërmjetësimi në fushën penale si platformë për të drejtën restorative? Etj.

Në **Kapitullin II** me titull: **rregullimi i ndërmjetësimit dhe të drejtës restorative në rajon ku** do të trajtohen çështjet si rregullimi i ndërmjetësimit në fushën penale në Republikën e Shqipërisë; Ndërmjetësimi në fushën penale në Republikën e Maqedonisë; Ndërmjetësimin në fushën penale në Republikën e Kroacisë; Ndërmjetësimi në fushën penale në Republikën e Bosnës dhe Hercegovinës; Ndërmjetësimi në fushën penale në Republikën e Malit të Zi; Ndërmjetësimi në fushën penale sipas sistemit të SHBA-së dhe legjislacioni i Bashkimit Evropian me theks të vecantë në ndërmjetësimin në Gjermani, Francë, Finlandë, Austri, Portugali etj.

Në **Kapitullin III** me titull: **“Ndërmjetësimi në procedurën penale sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës”** janë trajtuar temat si në vijim: Ndërmjetësimi sipas Kodit të Procedurës Penale, Kodin Penal për të Mitur dhe sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur, Procedura e ndërmjetësimit në fushën penale, Protokollin i referimit të rasteve në ndërmjetësim dhe praktika e referimit.

Në **Kapitullin IV** me titull: **“Ndërmjetësimi në Gjykatën Themelore të Prishtinës për periudhën 2012-2017”** janë trajtuar temat si: dinamika dhe numri i rasteve të referuara në ndërmjetësim, dinamika dhe numri i rasteve të zgjidhura përmes ndërmjetësimit, dinamika e zgjidhjes së rasteve në ndërmjetësim, veprat penale për të cilat është zbatuar procedura e ndërmjetësimit dhe mënyrat e zgjidhjes së rasteve me ndërmjetësim.